

“ Studentët tanë shquhen për përgatitje të lartë akademike dhe profesionale, duke qenë përherë kampione në kompeticione sportive, në vend dhe në botë! ”

Pranimet

Pranimet në Universitetin e Prishtinës bëhen nëpërmjet konkurseve publike. Çdo person i cili e ka përfunduar maturën shtetërore dhe i përmbush kriteret e përcaktuara në konkursin për studentë të rinj, ka të drejtë të konkurrojë për t'u bërë pjesë e Universitetit tonë. Përmes një procesi të hapur dhe konkurrues, ju do të mund të bëheni pjesë e universitetit lider në vend.

Rreth nesh

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit njihet për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtime shkencore, por edhe për përgatitjen e kuadrove ekselente nga fusha e sportit dhe edukimit fizik.

Studentët tanë përbejnë pjesën dërmuese të profesionistëve sportivë në vend, siç janë: mësimdhënësit e edukimit fizik dhe sportiv, futbollistët, volejbollistët, pingpongistët, hendbollistët, karateistët, trajnerët e fitnesit, e shumë profesione të tjera të ndërlidhura.



Kontakti

Adresa:

Rr. "Eqrem Qabej", p.n. 10 000
Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni:

+383 38 243 747

Email:

fefs@uni-pr.edu

Webfaqja:

<https://fefs.uni-pr.edu/>



Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit

Kalendari akademik

15 janar	Përfundimi i ligjëratave (semestri dimëror)
15 janar – 15 shkurt	Provimet e semestrit dimëror
15 shkurt	Dita e Universitetit të Prishtinës
16 shkurt	Fillimi i semestrit veror
31 maj	Përfundimi i ligjëratave për vit akademik
Korrik	Konkursi për studimet bachelor
Shtator	Konkursi për studimet master
15 shtator	Përfundimi i vitit akademik
1 tetor	Fillimi i vitit akademik

Programet:

Bachelor

Edukimi Fizik dhe Sportit (240 ECTS)

Master

Edukim Fizik dhe Sport (60 ECTS)

Trajner Sportiv (60 ECTS)

Pse n'FEFS?

- Fakultet i kampionëve;
- Kurrikulë e specializuar;
- Diplomë që njihet ndërkombëtarisht;
- Mundësi për shkëmbime semestrale në universitete partnere në Evropë dhe më gjerë;
- Tarifa të ulëta studimi;
- Mësimdhënës me përvojë dhe eminentë në fushat përkatëse;
- Hapësira bashkëkohore, të cilat përbushin kërkesat për kërkim shkencor dhe studim;
- Bursa për studentët me arritje të larta;
- Partneritete të shumta me tregun e punës, të cilat krijojnë mundësi për: punë praktike, vende pune dhe ngritje në karrierë;
- Të diplomuar me punësueshmëri të lartë;



Edukimi Fizik dhe Sportit

FEFS ofron studime cilësore për studentët duke pasur gjithnjë pasur gjithnjë në qendër aftësimin, kualifikimin, përgaditjen e mësimdhënësve dhe stafit personal duke ju ofruar kompetenca dhe aftësi komplekse të cilat rrisin konkurrencën e tyre në tregun vendor, rajonal dhe ndërkombëtar të punës si në fushën e edukimit fizik ashtu edhe në fusha të tjera të shkencës sportive.

